



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 172/1 Prot.

Tiranë, më 24.01.2022

V E N D I M

Nr. 25, Datë 24.01.2022

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 142, datë 29.07.2021, të paraqitur nga V.M, kundër Bashkisë Mat¹ në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike²”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Me Vendimin nr. 367, datë 21.06.2016 të Kryetarit të Bashkisë Mat është komanduar në pozicionin “Përgjegjëse e Sektorit të Ndhmës Ekonomike dhe Paaftësisë”, dhe pas procedurave të konkurimit, me shkresën nr. 1718, datë 10.07.2017, është njoftuar për emërimin si nëpunëse civile në pozicionin e sipërcituar, pranë Bashkisë Mat. Gjatë gjithë periudhës së saj në detyrë nuk ka pasur asnjë masë disiplinore. Në datë 08.07.2020 është njoftuar për fillimin e procedurave të ristrukturimit të institucionit, dhe me datë 22.07.2020 është njoftuar për transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit, nga pozicioni “Përgjegjëse” në “Specialiste”. Njoftimi për transferim është kundërshtuar nga ana e saj, por ndodhur përpara një situate të vështirë, presionuese dhe diskriminuese nga Drejtues të zyrës së Burimeve Njerëzore është detyruar të pranohet detyrën si Specialiste e Ndhmës Ekonomike dhe PAK pranë Njësisë Administrative Burrel, ku efekti financiar fillonte me datë 09.08.2020. Edhe pse ulja në kategori nuk u pranua nga ankuesja, përsëri transferimi vazhdoi. Pas pesë ditësh, me shkresën nr. 3410, datë 14.08.2020,

¹ Në formularin e ankesës, V.M është ankuar kundër G.P, në cilësinë si Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të Bashkisë Mat për shkak të bindjes politike dhe gjendjes shëndetësore. Me e-mail-in datë 17.09.2021 dhe në seancën dëgjimore, ankuesja ka tërhequr pretendimin për shkak të gjendjes shëndetësore dhe kundër G.P.

² Referuar Kartës së Anëtarësisë, datë 15.12.2018, V.M është anëtare e subjektit politik: Partia Demokratike e Shqipërisë.

Bashkia Mat, ka njoftuar ankuesen për fillimin e procedurave të transferimit në Njësinë Administrative Derjan, ku largësia nga vendbanimi është 18 km dhe transporti është i vështirë për shkak të infrastrukturës dhe nuk ka linjë transporti nga qyteti i Burrelit, për në Njësinë Administrative Derjan. Ankuesja me shkresën datë 05.09.2020 ka kërkuar rishikimin e vendimit nr. 579, datë 31.08.2020 “Për transferimin e përkohshëm të nëpunësit civil”, pasi kushtet e saja shëndetësore e bënin të pamundur transferimin në një zonë kaq të largët, bazuar në nenin 48/3/a të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, por kjo kërkesë nuk i është marrë parasysh. Me datë 03.12.2020, është njohur përsëri me Vendimin nr. 772, “Për një ndryshim në Vendimin nr. 579, datë 31.08.2020”, në të cilin i është bërë me dije se për nevoja të institucionit, afati i transferimit është zgjatuar deri në datë 03.03.2021. Transferimi është bërë në kundërshtim me Urdhërin e ngritur nga Kryetari i Bashkisë Mat, nr. 5170, datë 25.11.2020 “Për miratimin e Rregullave dhe Procedurave Standarte të Punës të Harmonizuara, gjatë Periudhës së Epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”. Ndodhur në situatë presioni e të vështirë, ka konkuruar për pozicionin e Specialistit të Mbrojtjes së Fëmijëve, ku u shpall fituese, dhe prej datës 22.02.2021 mban pozicionin e specialistes së mbrojtjes së fëmijëve pranë Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Përkrahjes së Shtresave në Nevojë, pranë Bashkisë Mat. Pas 3 (tre) muajsh njihet me shkresën nr. 2500, datë 02.06.2021 “Njoftim për fillimin e procedurave të transferimit” dhe me shkresën nr. 2838, datë 22.06.2021 “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit” ku Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, mbështetur në propozimin e Komisionit të Ristrukturimit, vendosi ta transferojë nga pozicioni: “Specialiste e Mbrojtjes së Fëmijës, pranë Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Përkujdesjes së Shtresave në Nevojë” në pozicionin “Specialiste e Kadastrës së Tokës Bujqësore, pranë Njesisë Administrative Derjan”. Në datë 28.06.2021 ka kthyer përgjigje shkresës nr. 2838, datë 22.06.2021, por Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Mat e ka konsideruar jashtë afatit qëndrimin e saj lidhur me vendimin e transferimit. Në vijim i është kërkuar që të vijonte me procedurat e transferimit për pozicionin e ri pa marrë parasysh se në datë 01.07.2021, për shkak të gjendjes shëndetësore ka kërkuar konsultë nga mjeku specialist duke u pajisur me 14 ditë pushim dhe është planifikuar për ekzaminime pranë QSUT-së, ku përsëri është rekomanduar nga Komisioni Mjeko Ligjor i Spitalit Mat për 15 ditë raport mjekësor, prej datës 05.07.2021 deri me datë 03.08.2021 të dorëzuar pranë Administratores së Njesisë Administrative Derjan, si dhe planifikim për RM të kolonës Vertebrale, me datë 21.09.2021, pranë QSUT-së”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rikthimin në pozicionin si Specialiste e Mbrojtjes së Fëmijës, Drejtoria e Shërbimeve Sociale të Bashkisë Mat.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 142, datë 29.07.2021, të bërë nga V.M, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për

Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1123/2, datë 03.08.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga, G.P, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, për ankesën e bërë nga V.M si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Kopje të plotë të strukturës organizative dhe organike të Bashkisë Mat, përpara datës 08.07.2020.
 - Kopje të plotë të strukturës/ave organizative dhe organike të Bashkisë Mat, pas datës 08.07.2020 dhe kopje të raportit/ëve të Komisionit të Ristrukturimit.
 - Kopje të plotë të të gjithë procedurave të transferimit dhe zgjatjes së afatit të transferimit të V.M, nga data 08.07.2020 deri më sot.
 - Kopje të shkresave/kërkesave të ankueses dhe përgjigjet e dhëna nga Bashkia Mat, lidhur me transferimet e V.M.
 - Kopje të vlerësimit të punës së ankueses për vitet 2019 dhe 2020.
 - Kopje të masave disiplinore të dhëna ndaj ankueses (nëse ka).
 - Informacion, nëse Bashkia Mat ka pasur dijeni për gjëndjen shëndetësore të V.M.
 - Informacion nëse ka pasur zgjatje të afatit të transferimit dhe për punonjës të tjerë (nëpunës civil), gjatë periudhës 01.09.2020 deri në datë 31.12.2020. Nëse po, kopje të procedurës.
 - Kopje të urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Mat, nr. 5170, datë 25.11.2020 *“Për miratimin e Rregullave dhe Procedurave Standarte të Punës të Harmonizuara, gjatë Periudhës së Epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”*.

Me e-mail-in, datë 17.09.2021, V.M ka dërguar dokumentacion dhe shpjegime shtesë, dhe ka informuar se ka ndryshuar subjektin kundër të cilit ka drejtuar ankesën dhe shkakun e diskriminimit, duke vendosur se, ankohet kundër Bashkisë Mat, për shkak të bindjes politike, dhe në mes të tjerash sqaroi se: *“Me Vendimin nr. 772, datë 03.12.2020, “Për nevoja të instiucionit” transferohet në mënyrë të përsëritur pranë Njesisë Administrative Derjan, me një largësi 22,1 km nga qyteti i Burrelit, me rrugë të vështirë, e pa asnjë mjet transporti në orarin zyrtar (08.00-16.00). Ristrukturimi në Njësinë Administrative Burrel (shkrirja e Pozicionit të Përgjegjës të Nd.Ekonomike dhe Paaftësisë) në Bashkinë Mat, u bë me qëllim punësimin në Njësinë Administrative Koms, të A.L, duke e punësuar jashtë kriterëve profesionale, si Specialiste e Ndhmës Ekonomike dhe Paaftësisë të Njesisë Administrative Koms si dhe duke transferuar (V.T) si specialiste në këtë pozicion, banore në Njësinë Administrative Koms, duke e transferuar pranë Njesisë Administrative Burrel, në vendin e saj të punës. Pra, duke krijuar mundësinë e punësimit jashtë kriterëve specifike të pozicionit të punës të A.L në Njësinë Administrative Koms, si specialiste e Ndhmës Ekonomike dhe Paaftësisë. Ky ka qenë qëllimi diskriminues politik i transferimit të saj në Njësinë Derjan edhe pse prej 31 vitesh është banore e qytetit të Burrelit,*

si dhe me mbi 29 vite punë në profesion dhe me eksperience në fushën e Mbrojtjes Sociale, të Kujdesit Shoqëror dhe të Mbrojtjes së Fëmijës”.

Me shkresën nr. 3560/1, datë 22.09.2021, G.P, në cilësinë si drejtues i Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Mat, dërgoi dokumentacionin e kërkuar dhe në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Ankuesja e cila ndjehet e viktimizuar nga ana e tij si drejtues i njesisë së burimeve njerëzore, është një pozicion që nuk ka lidhje me pretendimin e V.M, por për shkak të pozicionit, ai zbaton propozimet që vijnë nga organe të tjera, si monokratike po ashtu dhe kolegjiale, siç është rasti i Komisionit të Ristrukturimit. Përmbushja e këtyre detyrave nuk është e bazuar në diskrecion, por në norma detyruese, ku në rastin konkret moszbatimi i tyre, do të përbënte moszbatim të detyrave, por edhe për këdo që ushtron një detyrë të ngjashme.*

Në ankesë përmendet (gjendja shëndetësore) sforcimet fizike dhe distanca 18 km të vendbanimit nga vendi i punës, sqarohet se pa paragjykuar rastin e ankueses, përgjithësisht nuk ka punë pa sforcime fizike, ndërsa largësia 18 km, është brenda kufijve të ligjit, i cili e kufizon transferimin e punonjësit në distanca mbi 45 km. Bazuar në ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe VKM 125/2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë” në procedurat e transferimit, parashikon rolin e njesisë së BNJ, që ka si detyrë, që në raste të tilla të shqyrtojë kërkesën e ardhur për transferim dhe të marrë vendim pas 10 ditëve, pas kalimit të afatit të refuzimit të punonjësit, për rastet kur kemi largësinë mbi 45 km nga vendbanimi i nëpunësit civil, dhe gjendja shëndetësore e konfirmuar nga mjeku, e bën të pamundur transferimit.

Në rastin në fjalë, nuk kemi pasur asnjë nga rastet përjashtimore të parashikuar në legjislacionin e sipërcituar, për më tepër që kjo procedurë është zbatuar dhe për punonjës të tjerë si, M.B apo N.O, të cilët njihen publikisht si përkrahës të së majtës. Gjithashtu, është transferuar edhe një punonjëse tjetër V.T, së cilës së bashku me dy punonjësit e tjerë (të dy me probleme shëndetësore) ju është shtyrë periudha e transferimit në të njëjtën mënyrë sikundër dhe ankueses, me një ndryshim të vetëm, atë të kohës kur kjo ka ndodhur. Lidhur me çështjen e arsimit, të cilën ankuesja e konsideron pozicionin e punës jashtë kriterëve të saja profesionale, sqarohet se procedura është ndjekur, dhe më pas drejtuesi i njesisë nxjerr vendimin sipas propozimeve të Komisionit të Ristrukturimit, të cilët kanë konstatuar se ankuesja ka përfunduar Universitetin Bujqësor, që nga pikëpamja e formimit arsimor, pavarësisht degës apo fakultetit është i përafërt me kolegët e tjerë në të njëjtat pozicione pune, ku dhe ato kanë përfunduar studimet në Universitetin Bujqësor, por në degë të tjera.

Pretendimi se transferimi i datës 31.08.2020, i rishikuar me datë 03.12.2020, është në kundërshtim me Urdhërin nr. 5170, datë 25.11.2020 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave standarde të punës të harmonizuara, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19 dhe periudhës së kohëzgjatjes së vitit shkollor 2020-2021”, nuk qëndron, pasi vendimi për transferim është marrë para daljes së këtij urdhëri dhe vendimi vijues ka ndryshuar vetëm datën e përfundimit të transferimit dhe nuk janë cënuar protokollet anti Covid-19, për faktin e thjeshtë se për të gjithë stafin janë marrë masat e duhura mbrojtëse dhe shërbimet kanë qenë të kufizuara.

Nga ana tjetër, një lloj sikundër ankuesja, kanë punuar dhe punonjësit e tjerë të Bashkisë, dhe nuk është bërë asnjë diferencim i posaçëm për ankuesen. Lidhur me shkresën nr. 2878, datë 22.06.2021, ku pretendohet se ka respektuar afatin pesë ditor, sjell në vëmendje parashikimet ligjore (Kodin e Procedurave Administrative dhe Kodin e Procedurave Civile) të cilat parashikojnë se afatet llogariten kalendarike dhe nuk është përgjegjësia e Sekretarit të Përgjithshëm, që ankuesja nuk ka respektuar afatin, ndërkohë që pesë ditë kanë qenë të mjaftueshme që ankuesja të paraqiste pretendimet e saj, ndaj njoftimit për transferim.

Çështja në lidhje me transferimin e ankueses, po ndiqet gjyqësisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e regjistruar me nr. 3520 akti, datë 10.09.2021”.

- Me shkresën nr. 1123/4, datë 28.09.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion shtesë nga Bashkia Mat, për ankesën e bërë nga V.M si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Kopje të plotë të raporteve të Komisionit të Ristrukturimit të ngritur për ndryshimet në strukturat e Bashkisë Mat.
 - Kopje të vlerësimit të punës së ankueses për vitet 2019 dhe 2020.
 - Kopje të plotë të dosjes së punës dhe kualifikimeve të punonjësës, A.L.

Me shkresën nr. 3560/2, datë 29.09.2021, Bashkia Mat, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Lidhur me punonjësën A.L e emëruar në pozicionin e specialistes së Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë, sqarohet se emërimi, ka karakter të përkohshëm dhe është bërë për të siguruar vijueshmërinë e punës, për shkak se punonjësja që ka qenë në atë pozicion pune, fillimisht është transferuar dhe më pas ka konkurruar dhe është emëruar në një pozicion tjetër pune, nga ana tjetër pozicioni do të kalojë në procedurë konkurrimi nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore sipas planifikimit vjetor për këtë gjë. Në kohën që janë bërë këto lëvizje, ankuesja nuk ka paraqitur asnjë lloj pretendimi, dhe as kërkesë për të konkurruar për këtë pozicion pune, ndërkohë tani kujtohet për këtë. Në kohën kur është zhvilluar procedura e ristrukturimit, ankuesja nuk ka bërë me dije asnjë lloj pretendimi të tillë pranë Komisionit të Ristrukturimit, dhe ky i fundit ka vendosur duke u nisur nga interesi i institucionit dhe karakteristikat e vendit të punës të krijuar rishtazi, duke shqyrtuar të dhënat e dosjes së personave subjekt transferimi, sikundër janë arsimimi dhe lloji i diplomës, si dhe institucionin arsimor që ka lëshuar diplomën.*

Lidhur me faktin, që ankuesja shprehet se zbaton vetëm ligjin dhe nuk shprehet publikisht për bindjet politike brenda orarit të punës, ju informojmë se nuk është e vërtetë, pasi ankuesja në më shumë se një rast ka shprehur në vendin e punës dhe gjatë orarit zyrtar, bindjen e saj politike. Për të provuar këtë fakt, bashkëngjitur do gjeni deklaratat e kolegeve të saja që konfirmojnë këtë gjë. Lidhur me ndryshimin e strukturës së Bashkisë Mat, informohet se Kryetari i Bashkisë si titullar i njësisë së vetëqeverisjes vendore, i ushtron kopetencat e tij brenda kufizimeve ligjore në autonomi të plotë, duke përshtatur edhe strukturën sipas nevojave që lindin për përmbushjen me efikasitet të detyrave institucionale, në shërbim të komunitetit. Në vijim ju informojmë se ankuesja për

periudhën nga gjysma e dytë e vitit 2020 dhe 2021, ka munguar me raport 121 ditë, dhe së fundmi dy ditë pa arsye, për të cilat do të procedohet sipas dispozitave ligjore”.

Në kundërshtim të parashtrimeve të Bashkisë Mat, ankuesja me e-mail-in datë 04.10.2021, në mes të tjerash ka informuar Komisionerin se: *“Përsa i përket ristrukturimeve (dy herë) ndaj saj, Bashkia Mat, më parë ndryshonte strukturën organizative të punonjësve, dhe më pas fillonin procedura të ristrukturimit në Njësinë Administrative Burrel (vetëm në sektorin ku ajo punonte), dhe ristrukturimin e dytë pranë Sektorit të Shërbimit Social duke suprimuar vendin e punës, si Specialiste e Mbrojtjes së Fëmijës. Për vitin 2020 dhe 2021, strukturat organizative të punonjësve janë ndryshuar 4-5 herë në vit, me qëllim që të realizonin transferimet”.*

- Mbështetur në nenin 33/8, të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 142, datë 29.07.2021, Komisioneri me shkresën nr. 1438, datë 13.10.2021 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 28.10.2021, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Kopje të plotë të raporteve të Komisionit të Ristrukturimit të ngritur për ndryshimet në strukturat e Bashkisë Mat.
 - Kopje të vlerësimit të punës së ankueses për vitet 2019 dhe 2020.
 - Kopje të plotë të dosjes së punës dhe kualifikimeve të punonjësës, A.L.

Seanca u zhvillua me praninë e palëve në proces: subjektit ankues, V.M dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësuesit me autorizim nr. 4691, datë 26.10.2021, të Bashkisë Mat, G.P, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të Bashkisë Mat.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, u njoftuan palët se seanca dëgjimore do të mbahej në procesverbal dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, palët i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe me e-mail me KMD-në.

Gjatë seancës dëgjimore ankuesja deklaroi³ se shkak për transferimin e saj nga pozicioni si specialiste e ndihmës ekonomike në Njësinë Administrative Burrel në Njësinë Administrative Derjan, është bërë A.L, e cila një muaj pas transferimit të saj është emëruar si specialiste e ndihmës ekonomike në Njësinë Administrative Koms. Emërimi i saj është bërë pasi është anëtare e PS-së dhe ka marrë pjesë në komisionet e zgjedhjeve. Gjithashtu ankuesja deklaroi se nga viti 2004 deri në 2012 ka qenë Kryetare e Lidhjes së Gruas Demokratike të Shqipërisë (LGDSH) dhe më pas anëtare e kryesisë, por vitet e fundit ka qenë më e tërhequr në aktivitetin politik, por mbetet anëtare e PD-së. Ankuesja informoi se gjatë periudhës së transferimit të përhershëm për shkak të ristrukturimit nga ana e bashkisë nuk është respektuar dhe niveli i pagës, pasi në të dy transferimet

³ Referuar deklarimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 24.00, 29.30 dhe 1.03.15.

nuk është paguar sipas pagës së vendit të mëparshëm të punës që kishte pagë më të lartë (referuar nenit 48.5 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar).

Përfaqësuesi i Bashkisë Mat, i qëndroi parashtrimeve të bëra të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në, dhe deklaroi⁴ se vendimi i emërimit të A.L është i parregullt, por për të ofruar shërbimet në Njësinë Administrative Komsu u bë emërimi i saj, pasi është banore e zonës dhe ka arsimin e lartë.

Në përfundim të seancës, nga ana e përfaqësuesve të KMD-së, u kërkua nga Bashkia Mat të vihen në dispozicion të shqyrtimit të ankesës, informacion dhe kopje të akteve, lidhur me shpalljet e publikuara për vendin vakant në Njësinë Administrative Derjan dhe Komsu për pozicionin e specialistit të ndihmës ekonomike dhe planin që kishte menduar bashkia për plotësimin e vendit vakant pas përfundimit të periudhës së transferimit së V.M.

Në vijim të detyrave të lëna gjatë seancës dëgjimore, Bashkia Mat me e-mail-in datë 02.11.2021, dërgoi kopje të VKM nr. 243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, Urdhërin nr. 156, datë 10.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”, VKM nr. 237, datë 20.03.2020 “Për një shtesë në VKM nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, të ndryshuar”, dhe në mes të tjerash informoi se: “Në dosjen personale të V.M nuk ka asnjë vlerësim pune për vitet 2019-2020, ndërsa detyrat funksionale gjenden në rregulloren e brendshme të Bashkisë Mat”.

- Me shkresën nr. 1438/3, datë 08.11.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, lidhur me pjesëmarrjen e A.L në proceset zgjedhore.

Me shkresën nr. 6875/1, datë 12.11.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, informoi Komisionerin se: “Bazuar në dokumentacionin e administruar në KQZ, A.L në zgjedhjet për Kuvend të vitit 2017, me vendim të KZAZ-së nr. 16, Qarku Dibër, është emëruar në detyrën e anëtarit/kryetarit të KQV-së nr. 0949, e propozuar nga Partia Socialiste”.

- **Lidhur me kundërshtimin në gjykatë, të aktit administrativ nr. 2838, datë 22.06.2021 “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit” të Bashkisë Mat, për nëpunësin V.M.**

Bazuar në dokumentacionin e sjellë nga V.M me e-mail-in datë 29.12.2021, rezulton se: V.M duke mos rënë dakord me vendimin e transferimit, i është drejtuar me kërkesëpadi, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në të cilën ka kërkuar: - Shfuqizimin e vendimit nr. 2838, datë 22.06.2021 të Bashkisë Mat, “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit” dhe rregullimin e pasojave duke detyruar palën e paditur të rikthejë paditësen në pozicionin e mëparshëm “Specialiste e Mbrojtjes së Fëmijës”; - Detyrimin e palës së paditur për të sistemuar në të njëjtën drejtori “Drejtoria e Shërbimeve Sociale Bashkia Mat (e ndërtuar pas datës 02.06.2021)

⁴ Referuar deklaratimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 48.30.

pasi dhe pas ristrukturimit të këtij institucioni ka vende të ngjashme që përshtaten me kriteret specifike profesionale të saj; - Detyrimin e palës së paditur të paguajë diferencat e pagave mes pagave të marra pas vendimit të transferimit nr. 3094, datë 22.07.2020 “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit” deri në përfundim të gjykimit.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 3671 (80-2021-3729), datë 21.12.2021, ka vendosur: - Pranimin e kërkesë-padisë së paditëses V.M. – Shfuqizimin e aktit administrativ, Vendimit nr. 2838, datë 22.06.2021 të Bashkisë Mat, “Për transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit” të paditëses V.M. – Detyrimin e palës së paditur Bashkia Mat, të sistemojë paditësen V.M, në pozicionin e mëparshëm, ose një pozicion tjetër që përshtatet me kriteret specifike profesionale të saj, të së njëjtës kategori dhe pagë pranë institucionit të Bashkisë Mat. – Detyrimin e palës së paditur Bashkia Mat, ti paguajë paditëses V.M, diferencat e pagave mes pagave të marra pas vendimit të transferimit nëpërmjet Vendimit nr. 3094, datë 22.07.2020 “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit” deri në përfundim të gjykimit. -

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 12/1/c, ku përcaktohet se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ... c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, bazuar në bindjet politike, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

Me Vendimin nr. 367, datë 21.06.2016 të Kryetarit të Bashkisë Mat, V.M, me arsim të lartë (Fakulteti i Ekonomisë Agrare, Dega Financë), është komanduar në pozicionin Përgjegjëse e Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë pranë Njesisë Administrative Burrel, Bashkia Mat.

Me Aktin e Emërimit nr. 1718, datë 10.07.2017, të Njesisë së Burimeve Njerëzore, V.M është emëruar nëpunëse civile, në pozicionin Përgjegjëse i Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësine Administrative Burrel, Kategoria e pagës III-b.

Me shkresën nr. 2812, datë 08.07.2020 të Komisionit të Ristrukturimit të ngritur pranë Bashkisë Mat, ankuesja është njoftuar për fillimin e procedurave të ristrukturimit të pjesshëm të institucionit. Në vijim me shkresën nr. 3094, datë 22.07.2020 “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”, ankuesja është transferuar nga pozicioni Përgjegjëse e Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësine Administrative Burrel, kategoria e pagës III-b, në pozicionin Specialiste e Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësine Administrative Burrel, kategoria e pagës IV-a. Efektet financiare fillojnë nga data 09.08.2020.

Ankuesja, në përgjigje të shkresave të mësipërme, me shkresën datë 30.07.2020 drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm ka informuar se pranon transferimin brenda institucionit të ristrukturuar në Njësine Administrative Burrel.

Vetëm 5 ditë nga transferimi për shkak të ristrukturimit, ankuesja me shkresën nr. 3410, datë 13.08.2020 të Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, “Njoftim për fillimin e procedurave të transferimit”, është njoftuar se do të fillojë procedura e transferimit në pozicionin, Specialiste e Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësine Administrative Derjan.

V.M në përgjigje të shkresës së mësipërme, me shkresën datë 20.08.2020 ka informuar Njësine e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore se vuan nga “Hernie-diskale L4-L5” dhe të gjitha diagnozat janë të konfirmuara me ekzaminime të specializuara dhe analiza nga mjekë specialistë të Spitalit Universitar të Traumës. Gjithashtu ankuesja ka sqaruar se vërtetimi mjekësor i dërguar për në dosjen e punës disa ditë më parë, që është klinikisht e shëndoshë do të thotë se është e aftë për të

kryer detyrat e punës në pozicionin si Specialiste e Ndhmës Ekonomike në Njësinë Administrative Burrel, si dhe ka kërkuar që të verifikohet dhe vlerësohet më parë dokumentacioni mbi gjendjen e saj shëndetësore dhe më pas të merret vendimi për transferimin e saj, pasi është në kushtet e nenit 48, pika 3, a)⁵ të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Me Vendimin nr. 579, datë 31.08.2020 “Për transferim të përkohshëm të nëpunësit civil”, ankuesja është transferuar për nevoja të institucionit në pozicionin Specialiste e Ndhmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësinë Administrative Derjan, Bashkia Mat. Në këtë shkresë, lidhur me gjendjen shëndetësore të V.M, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, ka informuar se, nuk konstatohet asnjë vërtetim mjekësor që të konfirmojë pamundësinë e transferimit për shkak të gjendjes shëndetësore të V.M.

V.M në përgjigje të shkresës së mësipërme, me shkresën datë 05.09.2020 ka informuar Njësinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore se me datë 01.09.2020 kur është njohur me vendimin e transferimit ka qenë e shtruar në Spitalin Universitar të Traumës Tiranë, prandaj bashkëlidhur shkresës po dërgon, përmbledhjen e daljes nga Spitali i Traumës dhe raportet mjekësore të lëshuara nga spitali, si dhe ka kërkuar rishikimin e Vendimit nr. 579, datë 31.08.2020, për transferimin e saj.

Me shkresën nr. 3626/2, datë 15.09.2020, Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Mat, i është përgjigjur ankueses duke e informuar se procedura e transferimit ka kohë që ka filluar dhe është bazuar në të dhënat personale, përfshirë dhe gjendjen shëndetësore të vërtetuar me raport mjekësor të lëshuar para pak ditësh dhe pozicioni i punës ku jeni transferuar, nuk ka ngarkesë pune mbi atë të cilin keni kryer deri më tani (nuk ka sforcime fizike, ngritje peshash apo ecje të gjata) dhe nuk është vend pune ku ju është kërkuar që të shkoni në këmbë dhe nuk jemi para kushteve, ku Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore duhet të rishikojë Vendimin nr. 579, datë 31.08.2020.

Me Vendimin nr. 772, datë 03.12.2020 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 579, datë 31.08.2020 “Për transferim të përkohshëm të nëpunësit civil”, është njoftuar ankuesja se afati i transferimit të mësipërm është shtyrë deri me datë 03.03.2021.

Në vijim ankuesja, me anë të një shkrese i është drejtuar Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në të cilën e ka informuar se ndodhet me raporte mjekësore për paaftësi të përkohshme në punë të lëshuar nga mjeku neuro-kirurg dhe nga Komisioni Mjeko Ligjor, nga data 18.11.2020 deri në datë 02.12.2020, nga data 02.12.2020 deri në datë 17.12.2020 dhe nga data 17.12.2020 deri në datë 01.01.2021, dhe për arsye të gjendjes shëndetësore ka kërkuar që të përfshihet në grafikun e nëpunësve që do të kryejnë detyrat online.

Më pas, V.M ka konkuruar për lëvizje paralele për pozicionin e specialistit për Mbrojtjen e Fëmijës në Sektorin e Ndhmës Ekonomike dhe Përkujdesjes së Shtresave në Nevojë, të Bashkisë Mat. Në përfundim të procedurave të konkurimit për lëvizje paralele, ankuesja me Aktin e Emërimit nr. 888, datë 22.02.2021, është emëruar nëpunëse civile në pozicionin, Specialiste për Mbrojtjen e

⁵ 3. Nëpunësi civil mund të refuzojë transferimin në këto raste: a) kur gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur.

Fëmijës pranë Sektorit të Ndhmës Ekonomike dhe Përkujdesjes së Shteresave në Nevojë, Drejtoria e Shërbimeve Bashkiake, kategoria e pagës IV-a.

Me shkresën nr. 2500, datë 02.06.2021 të Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, ankuesja është njoftuar për fillimin e procedurave të transferimit në pozicionet e reja të parashikuara në strukturën e re për vitin 2021. Në vijim me shkresën nr. 2838, datë 22.06.2021 “*Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit*”, ankuesja është transferuar nga pozicioni Specialiste e Mbrojtjes së Fëmijës – kategoria e pagës IV-a, në pozicionin Specialiste e Kadastrës së Tokës Bujqësore pranë Njesisë Administrative Derjan – kategoria e pagës IV-a. Efektet financiare fillojnë nga data 05.07.2021.

Ankuesja me shkresën datë 28.06.2021 drejtuar Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ka kërkuar rishikimin e vendimit të transferimit pasi bie ndesh me frymën e ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe VKM-në nr. 125, datë 17.02.2016.

Me shkresën nr. 2838/1, datë 30.06.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm, ankuesja është informuar se është përgjigjur jashtë afateve të ankimit, pasi ka marrë dijeni për transferimin në datë 22.06.2021 dhe ajo është përgjigjur në datë 28.06.2021, jashtë afatit 5 (pesë) ditor të parashikuar.

Marrëdhëniet juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunësit civil, për rastin e ristrukturimit të institucionit dhe transferimit të përkohshëm dhe të përhershëm, rregullohen sipas parashikimeve të:

- Ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.
- VKM nr. 125, datë 17.02.2016 “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”.

Në nenin 48 të Ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, parashikohet procesi i transferimit të përkohshëm të nëpunësit civil. Në pikën 1 të këtij neni parashikohet se: “*1. Nëpunësi civil mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori, për këto arsye dhe kohëzgjatje: a) në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 viteve; b) për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 viteve; c) për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzënisë, në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për aq sa është e nevojshme sipas vendimit të komisionit përkatës. 2. Transferimi mund të bëhet: a) brenda institucionit ku është emëruar, përfshirë edhe degët e tij territoriale; b) në një institucion të varësisë të institucionit ku është emëruar; c) në një institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Nëpunësi civil mund të refuzojë transferimin në këto raste: a) kur gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur; b) nëse vendi ku transferohet gjendet më shumë se 45 km nga vendbanimi i nëpunësit civil. 4. Në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësi civil kthehet në pozicionin e mëparshëm. 5. Gjatë periudhës së transferimit, nëpunësi civil përfiton pagën më të lartë ndërmjet pagës së pozicionit të mëparshëm dhe atij në të cilin është transferuar. Në çdo rast, nëse është e zbatueshme, nëpunësi civil përfiton shtesën për kushtet e punës të pozicionit në të cilin është transferuar*”.

Në Kreun I të VKM-së nr. 125, datë 17.02.2016 përcaktohen procedurat për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësit civilë, për nivelin ekzekutiv, të ulët dhe të mesëm drejtues. Në pikën 9 të këtij akti parashikohet se: *“9. Nëpunësi civil ka të drejtë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, të refuzojë me shkrim transferimin e përkohshëm pranë njësisë përgjegjëse dhe të dëgjohet prej saj, nëse: a) Gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur; b) Vendi ku transferohet gjendet më shumë se 45 km nga vendbanimi i nëpunësit civil”*.

Nga faktet dhe provat e administruara, rezulton se V.M me shkresat datë 20.08.2020 dhe 05.09.2020, ka informuar punëdhënësin dhe ka faktuar me dokumente mjekësorë gjendjen e saj shëndetësore. Kështu rezulton se referuar indikacionit klinik të mjekut radiolog të Spitalit Universitar të Traumës, datë 16.09.2019, ankuesja vuan nga stenoza e kanalit lumbar në L4-L5. Referuar përmbledhjes së daljes nga Spitali Universitar i Traumës rezulton se ankuesja ka qenë e shtruar në spital nga data 31.08.2020 deri në datë 04.09.2020 me diagnozën: Syndrome RLS-Dex. H-D L4-L5, dhe i është rekomanduar nga mjeku të evitohet sforcimet fizike, ngritjet e peshave, ecjet e gjata, etj, për një periudhë 6-mujore.

Referuar raporteve për paaftësi të përkohshme në punë rezulton se ankuesja ka qenë me raport mjekësor me diagnozën: Hernie diskale L4-L5 dexter, si vijon: datë 31.08.2020 deri më 14.09.2020; datë 14.09.2020 deri më 18.09.2020; datë 18.11.2020 deri më 02.12.2020; datë 02.12.2020 deri më 17.12.2020 dhe datë 17.12.2020 deri më datë 01.01.2021.

Referuar përgjigjeve të dhëna nga Bashkia Mat, rezulton se nga ana e tyre nuk është bërë asnjë verifikim në lidhje me bazueshmërinë dhe vërtetësinë e këtyre raporteve mjekësore, por është mjaftuar me përgjigjen se keni dërguar raport ku rezultoni e aftë për punë dhe pozicioni ku jeni transferuar nuk ka ngarkesë pune mbi atë që keni kryer deri më tani dhe nuk është vend pune ku ju është kërkuar të shkoni në këmbë.

Referuar, informacionit të dërguar nga palët rezulton se distanca nga qyteti i Burrelit për në Njësinë Administrative Derjan, është rreth 18 km.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar, rezulton se nga Bashkia Mat nuk është bërë asnjë vlerësim të punonjësve që plotësonin kërkesat e vendit të punës Specialiste e Ndhmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësinë Administrative Derjan dhe mund të transferoheshin. Duke pasur barrën e provës për të provuar arsyet e transferimin e përkohshëm të ankueses, Bashkia Mat në cilësinë e autoritetit përgjegjës, nuk vuri në dispozicion të Komisionerit asnjë informacion që të kishte bërë një vlerësim të tillë dhe në përfundim të vlerësimit, V.M ishte përzgjedhur si punonjësja që përmbushte kushtet më të mira për tu transferuar.

Ankuesja ka pretenduar se transferimi i saj i përkohshëm është bërë për të sistemuar në punë A.L. Lidhur me këtë pretendim, rezulton se:

- Administratori i Njësisë Administrative Derjan me shkresën nr. 144, datë 11.08.2020, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkisë Mat, ka kërkuar se për shkak të daljes në

pension të punonjësës së Ndhmës Ekonomike, të transferohet një punonjës deri sa të bëhet procedura e rekrutimit.

- Me Vendimin nr. 579, datë 31.08.2020 *“Për transferim të përkohshëm të nëpunësit civil”*, V.M është transferuar për nevoja të institucionit në pozicionin Specialiste e Ndhmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësinë Administrative Derjan, Bashkia Mat.
- Me Vendimin nr. 676, datë 14.10.2020 *“Për transferim të përkohshëm të nëpunësit civil”*, V.T nga nëpunëse civile në pozicionin Specialiste e Ndhmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësinë Administrative Koms, transferohet në të njëjtin pozicion në Njësinë Administrative Burrel (në pozicionin që kishte V.M).
- Me Urdhërin nr. 679, datë 16.10.2020 *“Për emërim punonjësi”*, A.L është emëruar në pozicionin Specialiste e Ndhmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësinë Administrative Koms (në pozicionin që kishte V.T).

Në Ligjin 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në nenin 22 parashikohet se: Pranimi në shërbimi civil: *“1. Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive bëhet nëpërmjet një konkurimi të hapur. 2. Konkurimi organizohet në mënyrë periodike nga njësia përgjegjëse për secilin nga grupet e përcaktuara në pikën 8 të nenit 19 të këtij ligji”*, në nenin 23, pika 4 parashikohet se: *“Çdo emërim në pozicionin ekzekutiv, në kundërshtim me këtë nen, është absolutisht i pavlefshëm”*. Në nenin 25, pika 1 të këtij ligji përcaktohet se: *“1. Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë ekzekutive, atë të ulët apo të mesme drejtuese bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”*.

Referuar legjislacionit të sipërcituar, rezulton se emërimi i A.L është bërë në kundërshtim me dispozitat e parashikuara në ligjin 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, pasi nuk i është nënshtruar konkurimit të hapur, gjë që është pranuar gjatë seancës dëgjimore dhe nga përfaqësuesi i Bashkisë Mat, kur deklaroi se vendimi i emërimit të A.L është i parregullt.

Gjithashtu nga ana e Bashkisë Mat nuk u dërgua asnjë dokumentacion lidhur me masat e marra nga strukturat përgjegjëse për organizimin në mënyrë periodike të shpalljeve për pranimin në shërbimin civil për pozicionet e punës në Njësinë Administrative Derjan dhe Koms. Nga dokumentacioni i dorëzuar nuk rezulton se A.L i është nënshtruar konkursit për pranimin në shërbimin civil, për pozicionin Specialiste e Ndhmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësinë Administrative Koms.

Në këtë kontekst, duke parë se Bashkia Mat, 5 ditë pasi kishte transferuar ankuesen për shkak të ristrukturimit, e transferon përsëri në një pozicion tjetër në një largësi të pafavorshme për gjendjen e saj shëndetësore, duke mos bërë asnjë vlerësim/krahasim me punonjës të tjerë që mund të transferoheshin dhe duke vlerësuar procedurat e emërimit të A.L, Komisioneri vlerëson se ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme gjatë procesit të transferimit të përkohshëm në Njësinë Administrative Derjan, nga ana e Bashkisë Mat.

Lidhur me procesin e transferimit për shkak të ristrukturimit të institucionit në datë 22.06.2021, nga pozicioni Specialiste e Mbrojtjes së Fëmijës, në pozicionin Specialiste e Kadastrës së Tokës Bujqësore pranë Njësisë Administrative Derjan.

Në Ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në nenin 50 parashikohen procedurat për transferimin e nëpunësit civil në rastin e mbylljes së institucionit. Në këtë nen përcaktohet se: “1. Nëse për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet me precedencë, sipas kësaj renditjeje: a) në të njëjtin institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar; b) në institucionin, me të cilin institucioni është shkriur apo bashkuar, në një nga institucionet, në të cilat institucioni është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi; c) në institucionet e varësisë së institucionit të ristrukturuar; ç) në një institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Në çdo rast mbylljeje apo ristrukturimi krijohet një komision ristrukturimi. Komisioni shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë, në të cilin ai plotëson kërkesat specifike. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia përgjegjëse, në bazë të propozimit të komisionit”.

Në Kreun II të VKM-së nr. 125, datë 17.02.2016 parashikohen procedurat e transferimit për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit. Në pikën 18 të këtij akti parashikohet se: “18. Komisioni i ristrukturimit në propozimin e tij për transferimin e nëpunësve civilë për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit mbështetet në kriteret specifike të vendeve të lira apo të krijuara të reja si pasojë e ristrukturimit dhe të dhënat e nëpunësve civilë, vendet e të cilëve preken si pasojë e ristrukturimit. Vendimi është individual për çdo nëpunës civil”.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar rezulton se V.M është diplomuar në Institutin e Lartë Bujqësor të Tiranës, në Fakultetin e Ekonomisë Agrare, në Degën Financë.

Rezulton se për pozicionin e Specialistit të Kadastrës së Tokës Bujqësore, kërkohet si kriter specifik Master Shkencor në fushën e Agronomisë apo Shkencave Bujqësore⁶.

Referuar dokumentit mbi praktikën e ndjekur për marrjen e vendimit për transferimin të punonjësës V.M nga ana e Komisionit të Ristrukturimit, rezulton se komisioni ka arsyetuar si vijon: “Hapi 3. U krye verifikimi i dosjeve personale të nëpunësve të prekur nga ristrukturimi. Ku rezultoi se punonjësja V.M ka përvojë në administratë me statusin e nëpunësit civil. Gjithashtu, nga pikëpamja e formimit arsimor, përmbush kriteret për të kryer detyrën e Specialistit të Kadastrës së Tokës Bujqësore pranë Njesisë Administrative Derjan”.

Përsa më sipër rezulton se nga ana e Komisionit të Ristrukturimit nuk është bërë vlerësimi i kriterit specifik të pozicionit, sipas kriterit ligjor, për të cilin kërkohet Master Shkencor në fushën e agronomisë apo shkencave bujqësore, por është argumentuar se punonjësja V.M ka mbaruar Universitetin Bujqësor dhe plotëson kriterin specifik. Rezulton se ankuesja është diplomuar në degën financë dhe arsimimi i saj nuk ka krahasim me kriterin specifik të kërkuar për pozicionin Specialiste e Kadastrës së Tokës Bujqësore. Gjithashtu, Bashkia Mat ishte në dijeni dhe të gjendjes së rënduar shëndetësore të ankueses të përmendur më sipër, por dhe të deklaruar nga bashkia me

⁶ Referuar Vendimit nr. 3671, datë 21.12.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

shkresën nr. 3560/2, datë 29.09.2021 kur informon Komisionerin se: “.....punonjësja V.M për periudhën nga gjysma e dytë e vitit 2020 dhe 2021 ka munguar me raport mjekësor 121 ditë.....”.

Lidhur me argumentat e parashtruara, Komisioneri ka vlerësuar se ato janë të pabazuara dhe nuk qëndrojnë, për arsye se Bashkia Mat:

- Nuk ka bërë asnjë vlerësim të punonjësve që plotësonin kërkesat e vendit të punës, Specialiste e Ndhmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësinë Administrative Derjan dhe mund të transferoheshin.
- Nuk ka verifikuar dhe vlerësuar gjendjen shëndetësore të ankueses.
- Nuk ka respektuar procedurat e parashikuara në ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil”, gjatë procesit të plotësimit pozicionit të Specialistit të Ndhmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësinë Administrative Koms, duke emëruar A.L.
- Nuk ka vlerësuar si duhet kriterin specifik të arsimit për pozicionin e Specialistes së Kadastrës së Tokës Bujqësore në Njësinë Administrative Derjan, duke transferuar V.M dhe duke mos i ofruar një pozicion tjetër sipas parashikimeve ligjore.

Në analizë të gjithë sa më sipër, rezulton se ankuesja brenda një periudhe prej më pak se një viti i është nënshtruar një transferimi të përkohshëm për nevoja të institucion dhe një transferimi të përhershëm si rezultat i ndryshimit të strukturës të institucionit dhe në të dy rastet ankuesja është transferuar në një distancë prej 18 kilometrash nga vendi i banimit, duke mos dhënë një justifikim të arsyeshëm për këto transferime. Në referencë të parashikimeve ligjore që normojnë marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë, është më se e qartë se ligji ngarkon punëdhënësin me barrën e provës për të vërtetuar shkaqet e deklaruara të ndryshimit të vendit të punës.

Për sa më sipër, Komisioneri duke mos gjetur arsye objektive dhe të ligjshme për transferimin e përhershëm të ankueses në pozicionin e Specialistes së Kadastrës së Tokës Bujqësore në Njësinë Administrative Derjan, konstaton se V.M është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme nga ana e Bashkisë Mat.

B. Shkaku i mbrojtur.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon ndër të tjera, zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me bindjet politike, pretenduar nga ankuesi si shkak diskriminues, duke parashikuar në nenin 1, të tij se : “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Këtë qëndrim mban dhe Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, e cila, në vendimin nr. 31/2021, në pikën 67, të tij, shprehet se: *“...nacioni bindje politike përfshin jo vetëm shprehjen e pikëpamjeve politike dhe pjesëmarrjen në debatin politik apo inkuadrimit, organizimin kolektivisht ose pjesëmarrjen në organizata apo parti politike, por edhe të drejtën për të pasur ide ose pikëpamje që nuk bëjnë pjesë në ndonjë platformë apo program të partive politike, si dhe të drejtën për të mos iu bashkuar strukturave të organizatave ose partive politike. Në këtë kuptim, trajtimi i njëjtë nga pjesa e dispozitës ligjore të kundërshtuar i subjekteve që ndodhen në situata faktike të ndryshme për shkak të bindjeve politike, përbën diskriminim të padrejtë, për të cilin, ashtu siç u arsyetua më lart në këtë vendim, nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive”.*

Nëpërmjet kartës së anëtarësimit në subjektin politik Partia Demokratike datë 15.12.2018, rezulton se ankuesja ka provuar bindjen e saj politike. Gjithashtu, dhe më përpara, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me Vendimin nr. 36, datë 24.03.2015 ka konstatuar diskriminimin e V.M nga ana e Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat, për shkak të bindjes politike.

Rezulton gjithashtu se, A. M. është zgjedhur Kryetar i Bashkisë Mat në Qershor 2019, i propozuar si kandidat për Kryetar Bashkie, nga forca politike, Partia Socialiste⁷. Gjithashtu, bazuar në publikimet e faqes zyrtare të Bashkisë⁸, lidhur me aktivitetin politik të A.M. citohet se: *“...Prej Majit të vitit 2015 deri në Nëntor 2016 ka qenë Kryetar i Partisë Socialiste në Bashkinë Mat, ndërsa nga Nëntori 2016 e në vazhdim është Koordinator elektorale për Bashkitë Mat dhe Klos...”.*

Kodi i Procedurës Administrative, në nenin 80, pika 3, e tij ka përcaktuar se: *“Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme”.*

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, nga ana e subjektit ankues, atë të *“bindjes politike”*, të kundërt me Kryetarin e Bashkisë Mat, titullar i institucionit dhe punëdhënës i tij.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të paligjshëm me shkakun e mbrojtur.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Mat, sa i takon transferimit të saj në Njësinë Administrative Derjan në dy pozicionet e punës të analizuar më sipër.

Nga ana e Bashkisë Mat nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin që transferimet e ankueses, kishin ardhur për arsye objektive të justifikuar.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

⁷ Referuar Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve www.cec.gov.al

⁸ https://bashkiamat.gov.al/?page_id=564

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit “*Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional*”.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga GJEDNJ-ja si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, “*E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*”. Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin për shkak të bindjeve politike, në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të.

Ndërkohë Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: (a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; (b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; (c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; (d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik.

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejte parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

*Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*⁹, i cili sanksionon të drejtën për punë në nenin 6. E drejta për punë e garantuar në këtë nen vendos detyrimin për të garantuar të drejtën për të mos u privuar nga puna në mënyrë të padrejtë¹⁰. Sipas nenit 2/2, të Paktit, të drejtat e parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim bazuar ndër të tjera në bindjet politike të personit.

Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës¹¹ “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi. Konventa e përkufizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim ose favorizim i bërë në baza të caktuara i cili ka efektin e zhdukjes në barazi dhe mundësi ose trajnim në punësim dhe profesion. Në kuptim të kësaj Konvente termi “diskriminim” përfshin: a) çdo dallim, përjashtim ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, seksin, fenë, opinionin politik, prejardhjen kombëtare ose origjinën sociale, që ka për efekt të prishë ose të shtrembërojë barazinë e mundësive ose të trajtimit në fushën e

⁹ Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991

¹⁰ Komenti i Përgjithshëm Nr.8, Komiteti për të Drejtat Sociale Ekonomike dhe Kulturore, paragrafi 4.

¹¹ Ratifikuar me Ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

punësimi ose të profesionit, b) çdo dallim tjetër, përjashtim ose preferencë që çon në prishjen apo shtrembërimin e barazisë, të mundësisë ose trajtimit në drejtim të punësimi ose profesionit, që mund të specifikohet nga një anëtar i interesuar, pasi të ketë konsultuar organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe të punonjësve, si dhe organizma të tjerë të përshtatshëm.

*Karta Sociale Europiane*¹² në nenin 1, pika 2, parashikon: “Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për punë, Palët angazhohen.....2 të mbrojnë efektivisht të drejtën e punëtorit për të fituar jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht...” Ky parashikim, është interpretuar vazhdimisht nga Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale (KEDS) si vendosje e një të drejte për të mos u diskriminuar në punësim¹³. Garancitë për mbrojtjen nga diskriminimi parashikohen në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane, ku përcaktohet shprehimisht mbrojtja nga diskriminimi për shkak të bindjeve politike.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimin. E në fakt mosdiskriminimi dhe parimi i barazisë janë të ndërthurura ngushtë. Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata të jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme.¹⁴

Në bazë të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të ligjit përcaktohet se: “Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, neni 12, pika 1, germa a) dhe b), parashikon se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ...a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve”.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës. Parimi i

¹² Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

¹³ Shih: *Sidabras dhe Dëiautas kundër Lituaniës*, prg 30.

¹⁴ Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, paragrafi 15.

zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS¹⁵ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar¹⁶ ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër, në këtë rast Bashkisë Mat, e cila duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, për shkakun e pretenduar prej saj.

Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet dhe në nenin nenin 33, pika 7/1 të ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se : *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”*.

Në Komentin e Përgjithshëm nr. 20, *“Për mosdiskriminimin në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore”*, pika 10, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat Sociale, Ekonomike dhe Kuturore në vitin 2009, parashikohet se: *“...Diskriminimi i drejtëpërdrejtë përfshin gjithashtu veprime ose mosveprime të dëmshme mbi bazën e një shkakut të mbrojtur, kur nuk ka një situatë të ngjashme të krahasueshme”*.

Në situata të caktuara, kur trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm vjen si pasojë e mosrespektimit dhe moszbatimit të standarteve dhe kërkesave të miratuara nga legjislacioni në fuqi, krahasuesi për qëllime të të provuarit të sjelljes diskriminuese mund të konsiderohet standarti apo kërkesa që nuk është respektuar dhe që ka sjellë si pasojë trajtimin e padrejtë. Pra, për të vërtetuar sjelljen diskriminuese, nuk është e nevojshme në çdo rast identifikimi i një krahasuesi konkret, por kërkesat për të provuar se diskriminimi ka ndodhur konsiderohen të përmbushura edhe nga një krahasues hipotetik, që në rastin konkret është mënyra se si Bashkia Mat, duhet të kishte respektuar standartet dhe kërkesat ligjore të parashikuara nga legjislacioni i sipërcituar, për transferimet e përkohshme dhe të përhershme të nëpunësit civil.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

¹⁵ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

¹⁶ Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek pala e akuzuar, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë një të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.¹⁷

Nëse Bashkia Mat, që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë një të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.¹⁸

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është pikërisht bazuar në standartin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Bazuar në analizën e mësipërme rezultoi se ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme. Njëkohësisht, sa më sipër, rezultoi e provuar se ankuesi është anëtare e Partisë Demokratike, duke provuar në këtë mënyrë bindjet e saj politike. Ankuesja ka parashtruar se, fakti që bindjet e saj politike janë të kundërta me ato punëdhënësit, ka sjellë si pasojë trajtimin e saj të padrejtë dhe të pafavorshëm duke e transferuar në mënyrë të përsëritur në një vend pune larg vendbanimit duke i rënduar dhe më shumë gjendjen shëndetësore.

Rezulton se, në zgjedhjet vendore të zhvilluara në qershor të vitit 2019, është zgjedhur Kryetar Bashkie A. M., i propozuar si kandidat për Kryetar Bashkie, nga forca politike, Partia Socialiste¹⁹e Shqipërisë.

Për faktet që janë të njohura publikisht, bazuar në nenin 80/3 të Kodit të Procedurave Administrative, ku sanksionohet se: "*Për faktet të cilat janë të njohura publikisht, si dhe për ato fakte të cilat janë të ditura për organin administrativ për shkak të funksioneve të tij, nuk nevojitet verifikim*", nuk lind nevoja për verifikim.

Pra, nga sa më sipër cituar, A. M., ka patur një aktivitet të njohur politik, si pjesë e strukturave të Partisë Socialiste të Shqipërisë.

Për trajtimin diskriminues në pjesën dërrmuese të çështjeve nuk ekzistojnë prova të drejtpërdrejta. Bindjet politike përbëjnë një të dhënë sensitive të personit dhe shpesh herë punëdhënësi mbrohet me faktin se ai e ka të ndaluar që të mbledhë të dhëna për bindjet politike të punëmarrësve, e për rrjedhojë ai nuk ka si të ketë dijeni për bindjet politike të punëmarrësve të vet. Në lidhje me këtë moment, Komisioneri vlerëson se, provat rrethore mund të hedhin poshtë pretendimin e

¹⁷ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

¹⁸ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

¹⁹ <http://cec.org.al/wp-content/uploads/2019/07/Rez.-Perfund.-Kryetar-Bashkie.pdf>

punëdhënësit se nuk ka patur dijeni për bindjet politike të punonjësit dhe për këtë arsye të provohet se punëdhënësi ka patur dijeni.

Në parashtrimet e dërguara nga Drejtuesi i Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, të Bashkisë Mat me shkresën nr. 3560/1, datë 22.09.2021, citohet ndër të tjera se: “.. Ndërkohë me të njëjtat procedura janë transferuar edhe punonjës të tjerë, ku vendet e punës kanë qenë më larg se ankuesja nga vendbanimet respektive. Këtu mund të përmendim disa punonjës si M.B apo dhe N.O të cilët njihen publikisht si përkrahës të së majtës”.

Në analizë përse më sipër, Bashkia Mat, pranon faktin që ka patur dhe ka dijeni, sa i përket bindjeve politike të punonjësve të saj. Në këtë kuptim, pretendimi i bashkisë, se nuk ka patur dijeni mbi bindjet politike të ankueses nuk qëndron, madje nga parashtrimet e sipërcituara vërtetohet e kundërta.

Referuar kontekstit social-kulturor shqiptar dhe parashtrimeve të sipërcituara, evidentohet se në qytetet me një popullsi të vogël në numër, siç është Bashkia Mat²⁰, mendohet që banorët të kenë njohje me njëri tjetrin, si dhe të kenë dhe dijeni lidhur me bindjet politike të tyre. Për më tepër ushtrimi i funksioneve publike në administratën e qyteteve të vogla dhe marrëdhëniet e krijuara ndërmjet punonjësve në këto institucione mund të prezumojnë faktin që ata të kenë dijeni rreth aktivitetit politik të njëri tjetrit. Në rastin konkret, duke filluar prej vitit 2016 e në vijim ankuesja ka qenë punonjëse e Bashkisë Mat. Është publikisht i njohur fakti që Bashkia Mat është një bashki e cila ka qenë e drejtuar më parë nga kryetar bashkie i cili ka qenë përfaqësues i Partisë Demokratike²¹ dhe se në zgjedhjet vendore të vitit 2019, drejtimi i kësaj bashkie është marrë nga përfaqësues të Partisë Socialiste, si për sa i përket Kryetarit të Bashkisë ashtu edhe përfaqësuesve në Këshillin Bashkiak.

Bazuar në konstatimet e mësipërme, Komisioneri krijoi bindjen se ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të disfavorshme në procedurat e ndjekura për transferimin e saj. Duke iu referuar faktit se, ankuesja është anëtare e subjektit politik Partia Demokratike, prezumimit se punëdhënësi ka patur dijeni për bindjet e saj politike, dhe faktit që Bashkia Mat nuk arriti të provojë se nuk ka patur një trajtim të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe se transferimet janë bërë për një shkak të ligjshëm, krijohet dyshimi se veprimet e Bashkisë Mat kanë qenë të motivuara politikisht.

Pra në përfundim, Komisioneri konstaton se:

- Bashkia Mat nuk ka bërë asnjë vlerësim të punonjësve që plotësonin kërkesat e vendit të punës, Specialiste e Ndhmës Ekonomike dhe Paafëtisë në Njësinë Administrative Derjan dhe mund të transferoheshin.
- Bashkia Mat nuk ka verifikuar dhe vlerësuar gjendjen shëndetësore të ankueses.

²⁰ <https://portavendore.al/bashkia-mat/pasaporta-e-bashkise-mat/> Sipas Censurit 2011, Bashkia Mat ka popullsi prej 27.260 banorë.

²¹ http://cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/zgjedhje-vendore/2015/rez_hetml/151123_-_buletin.htm

- Bashkia Mat nuk ka respektuar procedurat e parashikuara në ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil”, gjatë procesit të plotësimit të pozicionit të Specialistit të Ndhmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësinë Administrative Komsi, duke emëruar A.L.
- Bashkia Mat nuk ka vlerësuar si duhet kriterin specifik të arsimit për pozicionin e Specialistes së Kadastrës së Tokës Bujqësore në Njësinë Administrative Derjan, duke transferuar V.M dhe duke mos i ofruar një pozicion tjetër sipas parashikimeve ligjore.

Komisioneri konstaton se transferimet e ankueses nga pozicionet që ka pasur në Njësinë Administrative Burrel, nuk kanë ardhur për arsye të justifikuara. Përsa më sipër, nga informacioni i vënë në dispozicion nga ankesat e paraqitura pranë Komisionerit, vërehet se nga Bashkia Mat, ka patur edhe punonjës²² të tjerë të larguar nga puna të cilët kanë pretenduar largimin nga puna për shkak të bindjeve politike.

Komisioneri vlerëson se nga ana e Bashkisë Mat nuk u arrit të provohej:

1. Që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga ankuesja dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë nga ana e punëdhënësit, të konstatuar edhe nga Komisioneri në këtë vendim.
2. Që për veprimet dhe mosveprimet e këtyre subjekteve kundrejt ankueses ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, pra që këto veprime dhe mosveprime ndiqnin një synim të ligjshëm dhe masat për arritjen e këtij synimi ishin proporcionale.

Sa më sipër Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Mat për shkak të bindjes politike. Për rrjedhojë Bashkia Mat ka shkelur dispozitat e Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nenin 3, pikat 1 dhe 2, dhe nenin 12, pika 1, gërma “c”.

Në përfundim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstaton se V.M, është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, nga ana e Bashkisë Mat, trajtim i cili ka ardhur si pasojë direkte e bindjes politike të saj.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”.

Në nenin 33, pika 12, të LMD-së, përcaktohet se: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar si pasojë e transferimit të ankueses nga Njësia Administrative Burrel, duhet të jetë sistemimi i ankueses në një pozicion që përshtatet me arsimin e saj, pranë Njësisë Administrative Burrel.

²² Ankesat e depozituara pranë KMD-së: Nr. 132, datë 16.11.2020, H. K. kundër Bashkisë Mat; Nr. 55, datë 17.06.2020, H. D. kundër Bashkisë Mat; Nr. 10, datë 07.02.2020, A. Ç. kundër Bashkisë Mat dhe Nr. 91, datë 11.08.2020, B. L. kundër Bashkisë Mat.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, të ankuseses V.M, për shkak të bindjes politike, nga ana e Bashkisë Mat.
2. Në referim të pikës 1, Bashkia Mat, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në një pozicionin që përshtatet me arsimin e saj, pranë Njësisë Administrative Burrel.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Bashkia Mat, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA